

KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 04.04. 2024, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

PALA E PARË: Shoqëria "BIGALB GROUP" Shpk, identifikuar me NIPT: L11521002M, Zotërues i një pjese në kapital, të barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga Znj. Elona KOSHI, e datëlindjes 04.09.1986, lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e numër personal I65904092M, që këtu e në vijim. "Shitësi"

PALA E DYTË: Z. Telat Arapi, i biri i Sherifit, i datëlindjes 06.08.1961, i lindur në Delvinë, Sarandë, dhe banues në Sarandë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) me Nr.Personal G10806062E, që këtu e në vijim "Blerësi"

PALA E TRETË: Z. Bahri Shaqiri, i biri i Femiut, i datëlindjes 08.06.1970, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 034140492 dhe nr personal H00608054R, që këtu e në vijim "Blerësi"

HYRJE

A. Shoqëria "Big Tepelena" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 11.10.2017, pajisur me nipt **L73411603N**, me seli në adresën Gjirokaster Gjirokaster GJIROKASTER Rruga Nacionale, Lagjja "Punetore", Rotondo e dyte, Zona kadastrale 8543,Nr.pasurie 7/63, me ortakë:

2.1.1 Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 100%;

B. Shoqëria "Big Tepelena" shpk do të shesë kuotat me vlerë nominale Z. Telat Arapi 1 (një) Kuotë me pjesëmarrje në përqindje 25% dhe Z. Bahri Shaqiri 1 (një) Kuotë me pjesëmarrje në përqindje 24%.

C. Ortaku, Shoqëria "BIGALB GROUP" shpk, me vendimin Nr. 1 të datës 04.04.2024, në mënyrë të shprehur ka vendosur shitjen e kuotave si më sipër.

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

Neni 1 Baza Ligjore

1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;

1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

Neni 2 Objekti

- 2.1 Të shesë kuotat me vlerë nominale Z.Telat Arapi 1 (një) Kuotë me pjesëmarrjen në përqindje 25% (njëzet e pesë për qind), me vlerë 1.250.000 lekë dhe Z.Bahri Shaqiri 1 (një) Kuotë me pjesëmarrjen në përqindje 24% (njëzet e katër për qind), 1.200.000 lekë.
- 2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "Big Tepelena" shpk, do të zotërohet nga ortakët si më poshtë:

1. Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Z. Telat Arapi: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 25% (njëzet e pesë për qind);
3. Z. Bahri Shaqiri: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 24% (njëzet e katër për qind).

Neni 3 Afati

3.1 Kuotat kalojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4 Vlera e shitjes

4.1 Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 1,250,000 (një milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për 1 Kuotë me përqindjen në pjesëmarrje prej 25%, dhe 1,200,000 (një milionë e dyqind mijë) lekë, për 1 Kuotë me përqindjen në pjesëmarrje prej 24%.

Neni 5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2 Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

Neni 6 Të tjera

- 6.1 Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2 Kontrata redaktohet në 3 kopje, me fuqi të njejtë.

6.3 Bashkangjitur dokumentat:

1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "Big Tepelena" shpk;
2. Vendim Nr. 1, datë 04.04.2024 i Shoqërisë "Big Tepelena" shpk;
3. Dokumentat ID të palëve

PALËT:

SHITËSI
BIGALB GROUP Sh.P.K.
Vullnet Sinaj
Person i Besuar
Elona Koshi

Elona Koshi



BLERËSI
Z. Telat Arapi

Telat Arapi

BLERËSI
Z. Bahri Shaqiri

Bahri Shaqiri